



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:087063

Datë: 09.07.2019

Numri i dokumentit: 00400141

**PKR.nr.36/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, me trupin gjykues në përbërje nga gjyqtarët Violeta Namani- Kryetare, Naser Foniqi e Hamdi Ibrahim –Anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shpresa Sahiti, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. L., E. R., dhe B. T., nga P..., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par,1 lidhur me par 31 të KPRK\_së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime te Rënda PP.nr.266/2017 të datës 31.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimin gjyqësor, me dt.15.05.2019, në të cilin ishin prezentë Prokurorja e Shtetit, të pandehurit A. L., av.Shpendi Bokshi, E. R., av.Zenel Kelmendi dhe B. T., av.Ahmet Tahiri, me datë 15.05.2019, në ora 11:00, publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**1.I pandehuri A. L.**, i biri i A... dhe F... , e gjinisë K... , i lindur me ..., në P... ku edhe jeton rr. “...” pa nr. i martuar, baba I ... fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, nuk posedon dokument identifikimi, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës ,

**2.I pandehuri E. R.**, i biri i H... dhe F..., e gjinisë G..., i lindur me ..., në P..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, I pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike , me nr. ID ..., shqiptar, shtetas i R. të Kosovës ,

**3.I pandehuri B. T.**, i biri i A..., dhe F..., e gjinisë E... , i lindur me ..., në P..., ku edhe jeton rr. “...” , nr. ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, I pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike , nuk posedon dokument identifikimi, shqiptar , shtetas i R. të Kosovës,

### **JANË FAJTOR**

Sepse:

Më datë 22.12.2017, rreth orës 00:30 minuta, në kafen” K...“, në fshatin V..., Komuna e P..., të pandehurit A. L., E. R., dhe B. T., në bashkëkryerje me qëllim që me përvetësim e sendeve të huaja të luajtshme, vetit ti sjellin përfitime pasurore të kundërligjshme, pas marrëveshjes paraprake, i pandehuri A... ia ofron çelësat e veturës tij të tipit “P...”, me targa ..., me ngjyrë të bardhë, të pandehurit E..., ku i pandehuri E... shkon e veturë që gjendet në parkingun e lokalit të lartcekur dhe nga bagazhi e merr agregatin e tipit “ Lombardini” në vlerë prej

1200E, dhe e fshehtë në therra te ura në fshatin V..., i cili agregat ishte pronë e familjes së dëmtuarit L. D., pasi që i dëmtuari L..., me kërkesën e pronarit të lokalit, paraprakisht para 30 minutave me veturën e të pandehurit A..., ka shkuar në shtëpinë e tij për ta marrë agregatin për arsye së në lokal është ndalë rryma, me pas i pandehuri E..., pas veprimeve të cekura më lart është kthyer në lokal, pas pesë minuta i dëmtuari L..., ka dalë nga lokali e ka kuptuar e dikush ja ka marrë agregatin, i njëjti i ka pyet të tre pandehurit se kush e ka vjedhë agregatin, asnjëri nuk i ka dhanë ndonjë njohuri, me pasi i akuzuari A. L., me veturën e tij e ka dërguar të dëmtuarin L... në shtëpi, ndërsa të pandehurit B. T., dhe E. R., kanë shkuar për të marrë agregatin në vendin ku e ka fshehtë i pandehuri E. R., me pas të tre të pandehuri janë takuar për të pi kafe në "A..." në V... në P..., ndërsa gjatë hetimeve dhe kontrollimeve të policisë, te shtëpia e të pandehurit E. R., kanë gjetur dhe sekuestruar agregatin e tipit "Lombardini", pronë e familjes të dëmtuarit L. D.,

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par,1 lidhur me par 31 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 41, 42,43, 45,46,73, 83, 325 par,1 lidhur me par 31 të KPRK-së dhe nenit 365, 450, 463 të KPRK-së, të pandehurit i :

## G J Y K O N

Të pandehurit A. L., i shqipton **dënim me burgim** në kohëzgjatje prej **(1) një viti** dhe **dënim me gjobë** prej **400 (katërqind) €**, të cilin dënim të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, në të cilin dënime do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgim dhe në masën e arrestit shtëpiak që nga data **22.12.2017 deri me datë 15.11.2018**.

Të pandehurit E. R., i shqipton **dënim me burgim** në kohëzgjatje prej **(1) një viti** dhe **dënim me gjobë** prej **400 (katërqind) €**, të cilin dënim të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, në të cilin dënime do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgim dhe në masën e arrestit shtëpiak që nga data **22.12.2017 deri me datë 09.11.2018**.

Të pandehurit B. T., i shqipton **dënim me burgim** në kohëzgjatje prej **(1) një viti** dhe **dënim me gjobë** prej **400 (katërqind) €**, të cilin dënim të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, në të cilin dënime do të llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgim dhe në masën e arrestit shtëpiak që nga data **22.12.2017 deri me datë 15.11.2018**.

Nëse dënimin me gjobë të akuzuarit nuk dëshirojnë ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burg duke i llogaritur nga një ditë burg për çdo 20 Euro.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç që ti paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej pesëdhjetë **(50) €**, dhe shumën prej pesëdhjetë **(50) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime te Rënda, sipas aktakuzës PP.nr.266/2017 të datës 31.01.2018, e ka akuzuar të pandehurit A. L., E. R., dhe B. T., nga P..., për shkak të veprës penale Vjedhje grabitqare, nga neni 328 par,2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës dt.01.03.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit A. L., E. R., dhe B. T., deklarojnë se nuk e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2019, Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare deklaron se është vërtetuar gjendja faktike dhe nuk është kontestuese se te pandehurit, pas marrëveshjes paraprake natën kritike kanë vjedhur agregatin pronë e të dëmtuarit –dëshmitarit L. D., sepse ky fakt është vërtetuar nga te gjitha deklaratat e të dëmtuarit L. D., po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit A. D., nga provat materiale, por edhe nga deklaratat e të pandehurve A. L., dhe E. R., qysh në fazën e shqyrtimit fillestar, si dhe i pandehuri B. T., në polici, kur kanë pranuar të kenë vjedhur agregatin, pronë e të dëmtuarit L..., dhe shton se dëshmia e dëshmitarit N. Z., të dhënë sot në gjykatë, po ashtu vërtetohet se i njëjti si si pronar i lokalit ‘K...’ në fshatin V..., i njëjti thekson se ky lokal ka kapacitet prej 300 mysafirëve dhe ne rastet kur ka ndërprerje të rrymës i njëjti e ka poseduar agregatin dhe nuk ka ndodhur asnjëherë dhe aq me tepër kur ka theksuar dhe i duket qesharake që në raste të tilla të kërkoj agregat nga mysafirët prezentë, po ashtu nga deklaratat e tij është vërtetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e të pandehurve se natën kritike aty ka ndodhur rrahje para lokalit në mes tyre kur ka marrë lëndime i dëmtuari L. D., edhe nga provat materiale, ekspertiza ligjore është vërtetuar se i dëmtuari natën kritike ka pësuar plagë shqyeje rreth syrit të majtë, me pas deklaron se i pandehuri E. R., ne fjalën përfundimtare e ka shfrytëzuar te drejtën ligjore qe te mbrohet ne heshtje ndërsa deklaratën te dhënë ne polici ka deklaruar se takuar ne te pandehuri B... dhe A... ne kafenenë ne fshatin V... dhe qe te dy i kane treguar se si e kanë vjedhur një agregat afër një shtëpi aty afër lokalit dhe me këtë vërtetohet se vjedhja grabitqare ka ndodhur ne shtëpi konkretisht ne serë, pretendon prokuroria e jo ne veturë pranë lokalit më pas të tre të pandehurit këtë agregat e kishin dërguar ne shtëpinë e te akuzuarit E... po ashtu edhe i pandehuri B. T., ne seancën e shqyrtimit gjyqësorë është mbrojtur ne heshtje ndërsa ne deklaratën e dhënë ne polici ka theksuar se kemi qenë ne kafen ne fshatin V... me te pandehurin A... dhe E..., i pandehuri E... e kishte marrur një agregat e kishte fshehur te ura e V..., pastaj ka dalur jashtë pronari i agregatit, kur është kthyer brenda i njëjti i ka thënë A... pse ma ke vjedhur agregatin me pas ka filluar përleshja mes A... pronarit te agregatit dhe personave te tjerë pas ndodhive të tre të akuzuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes, me automjetin e te akuzuarit A..., e kanë dërguar agregatin tek shtëpia e te pandehurit E..., nga dëshmia e dëshmitarit A. D., është vërtetuar se ne natën kritike i dëmtuari L. D., ka shkuar në shtëpinë e tij ne gjendje gati te alivanosur dhe te shtresuar po ashtu ka pasur lëndime dhe vetullën e ka pasur te qarë me pas i ka treguar për rastin që i ka ndodhë tek sera, ndërsa sa i për këtë dëshmisë së dëshmitarit Sh. I., gjykata nuk duhet të ja falë besimin sepse ky dëshmitar nuk është i ndenjtur pasi që i njëjti ka qenë nën ndikimin e të pandehurit A..., pasi qe te njëjtin e ka shok, po ashtu është ne kundërshtim me vetveten dhe ne marrëveshje ne mes tyre për te deklaruar ne gjykatë po ashtu njësoj është edhe deklarata e

dëshmitarit D. I., në dëshminë e tij nuk ka ndriçuar asgjë përpos që janë munduar ti lehtësojnë pozicionit e të pandehurit A... pasi që të dy e kanë shok, si përfundim i gjithë kësaj vërehet qartë se të pandehurit kanë deklarata krejtësisht kontradiktore njëra me tjetrën dhe gjykata nuk duhet me ja fale besimin sepse mbrojtja e tyre është dhënë në drejtim të ikjes nga përgjegjësia penale dhe duke u mundura që të ja hedhin fajin njeri tjetrit andaj konsideroj se të pandehurit janë penalisht përgjegjës, se me dashje direkte kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe i propozoj gjykatës që të pandehurit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e matjes se dënimit të kenë parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. L., av. Shpend Bokshi në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2019, në fjalën përfundimtare deklaron se prokuroria ka dështuar të argumentoj sesi u identifikuan të tre të akuzuarit të cilët kanë qenë me maska dhe nga vete deklaratat e të dëmtuarit është vërtetuar se nuk ka mundur me bëjë identifikimin e tyre, në konkludojm se i dëmtuari L. D., ka sajuar një ngjarje fiktive vetëm e vetëm për të pasur një arsytim ndaj babait të tij, se nuk ka qenë në kafe në fshatin V..., me arsytimin që të mshef arsyen dhe mënyrën se si ka kaluar disa orë duke vallëzuar dhe në të njëjtin lokal i ka shpenzuar 70 euro, andaj i njëjti e ka bartur ngjarjen në seren e tij, ndërsa të gjithë dëshmitarët, të akuzuarit kanë deklaruar se ngjarja ka ndodhur në kafenenë në fshatin V... dhe se i dëmtuari ka ardhur aty është argëtuar dhe ka pi pije, ka shpenzuar të holla, kur është ndalur energjia elektrike i dëmtuari është treguar i gatshëm që të sjell agregatin për të vazhduar ndejën në lokal, nuk është aspak bindëse dhe është krejt e pamundur që i dëmtuari L..., gjatë përlëshjes me persona të panjohur paska humbur kuletën ku në të ka pasur 70 euro dhe të njëjtën, e paska gjetur pas 4-5 ditëve skaj rrugës të asfaltuar në magjistralen Prishtinë - Podujevë, ku në kulet ka qenë dokumentacioni personal kurse të hollat jo. Andaj një aktakuzë e tillë nuk mund të qëndroj në deklaratën e tillë të dëmtuarit L..., të dhënë në polici dhe para këtij trupi gjykues dhe nuk mund të bëhet fjalë për veprën penale vjedhje grabitqare pasi që ngjarja nuk ka ndodhur në seren e të dëmtuarit ashtu siç e ka paraqitur i dëmtuari, ndërsa shton se sa i përket dëshmisë së dëshmitarit N. Z., gjykata duhet ta dije faktin se ai është propozuar si dëshmitar nga ana e mbrojtjes sepse ai me të vërtet e ka kërkuar agregatin nga mysafirët por se e ka harruar këtë rast, kjo harres sipas meje qëndron në faktin se dëshmitari që u muerr sod në pyetje ishte shumë i stresuar dhe këtë e përmendi para trupit gjykues disa here prandaj deklarata e këtij dëshmitari nuk duhet të merret parasysh dhe është në kundërshtim jo vetëm nga ana e deklaratat e të akuzuarave dhe deklaratat e dëshmitarëve tjerë, prandaj kërkoj nga gjykata që ndaj të mbrojturit tim të merr aktgjykim lirues, poqë se bëhet fjalë eventualisht për ndonjë vepër penale të vjedhjes, në qofte se gjykata të mbrojturin tim e shpall fajtor andaj të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, pasi që i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar se është i martuar dhe baba i ... fëmije, është i moshës së re dhe mbajtës i familjes dhe i premtor gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër të re penale.

I akuzuari A. L., në fjalën përfundimtare deklaron e mbështes fjalën e mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. R., av. Zenel Kelmendi në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2019, në fjalën përfundimtare deklaron se pajtohem tërësisht atë çka e tha kolegu im i mëparshëm qëndroj pran pretendimeve të cekura në kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen apo ndryshimin e aktakuzës të paraqitura me 29.03.2018, sqaroj se deklarata e të gjithëve janë kontradiktore dhe nuk përputhen, rasti është se ka

pas një marrëveshje në mes të akuzuarit A. L., dhe të dëmtuarit- dëshmitarit L. D., po ashtu shton se është kontestuese deklarata e të dëmtuarit L..., i cili ka deklaruar se prej orës 11:30, të dt. 21.12.2017, deri në ora 00:30, të dt. 22.12.2017, i dëmtuari në disa raste thotë, kam qenë i alavivanosur disa minuta kjo thuhet edhe në aktakuzë, e në raste tjera thotë vetëm kur më ka dalë ajo far kllapitje në ora 02:45 min, kjo është ndryshim i kohës, në deklaratën e dt. 22.12.2017, ka deklaruar se baba ka shkuar me vëllain me konstatua gjendjen se çka është vjedhë në serë, ndërsa në rastet tjera thotë se unë kam shku me babën dhe e kemi vërejte se çka është vjedhë në serë, po ashtu i dëmtuari deklaron disa herë se kur shkova në vendngjarje aty në serë e vërejte se është vjedh agregatin, për ne është me rëndësi deklarata para prokurores e të akuzuarit B. T., ku deklaron se të dëmtuarin e ka rrah A... me shokët e tij, dhe ajo se ka qenë të maskuar nuk ekziston, andaj sipas bindjes time rasti del i konstruktum dhe të gjitha janë bërë në marrveshje edhe me të dëmtuarin, po ashtu shton se klienti im e pranon prej fillimit që e ka marrë agregatin në oborrin e lokalit, andaj është çështje e trupit gjykues se si e vlerëson këtë sepse vjedhje grabitqare nuk mund të quhet kjo.

I akuzuari E. R., në fjalën përfundimtare deklaron e mbështes fjalën e mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. T., av. Ahmet Tahiri në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2019, në fjalën përfundimtare deklaron se lidhur me të mbrojturin e tij për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke u mbështetur në provat e administruara qofshin ato materiale apo në formë të dëshmitarëve në asnjë rast apo formë nuk u vërtetua teza e aktakuzës dhe besueshmëria e saj vetëm është vërtetuar se kjo aktakuzë është e pa qëndrueshme si në aspektin formal po ashtu edhe material. Andaj konsideroj se aktakuza është e pa çart, kundërthënëse me vetveten, i mungojnë elementet qenësore të veprës penale dhe për faktin se nuk ofron asnjë provë të vetme konkrete dhe të mbështetshme dhe të cilat të njëjtën do ta bëjnë të besueshme, ku e njëjta aktakuze është e mbështetur vetëm në deklaratën e vetëm të dëmtuarit- dëshmitarit L. D., ku i njëjti i dëmtuar që nga deklarata e dhënë ne polici e deri në fazën e shqyrtimit gjyqësor ka dhënë disa versione kinse të ngjarjes që nuk përputhen me njëra tjetrën, ndërkaq i mbrojturi im si në deklaratën e dhënë në polici dhe në prokurori ka dhënë dëshmi të cilat përputhen njëra me tjetrën, andaj janë vërtetuar se në veprimet e të mbrojturit tim mungojnë të gjitha provat dhe faktet që do ti mbështesin veprimet diskriminuese ne drejtim te veprës penale të cilës i vihet ne barrë, andaj kërkoj nga gjykata se pas analizimit te kësaj çështje penale ndaj të mbrojturit tim B. T., të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari B. T., në fjalën përfundimtare deklaron:se mbështet fjalën e mbrojtësit tim dhe e mbështes në tërësi.

Gjendjen faktike, gjykata e vërtetoi nga:

I dëmtuari L. D., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se unë punoj në piceria "H..." në P..., ku vazhdoj të punoj edhe tani, me orarin e punës e kam pas dite prej orës 16:00 deri në ora 23:00, në ditën kritike jam kthyer në shtëpi, jam ofruar te sera afër objektit kam hasur në një person, i cili kishte qenë duke e hapur derën e serës, pasi që dera e serës është e ngjitur me derën e objektit, personi ka qenë i gjatësisë kështu si unë ndërsa ftyrën nuk kam mujtë me vërejtur sepse për arsyeje ka pasur maskë të zezë

në fytyrë dhe se jam rrah me të, unë kam vazhduar me një stupc dru i stufës të madhe duke e goditur personin e njëjtë në shpinë, kam dashur që t'ia hjek maskën në atë moment kam pësuar goditje nga personat tjerë që me të kanë qenë së paku tre persona ose katër persona, prej atij momenti nuk kam mundur që ta kontrolloj veten sepse kam pasur goditje në kokë ku edhe e kam dokumentacionin mjekësor si dhe fotografit, goditjen e parë e kam marrë me grusht në pjesën e vetullës në anën e majtë, në pjesën e njëjtë në vesh edhe goditje tjera në pjesët e ndryshme të trupit nga të gjithë personat e pranishëm që kanë qenë me maska dhe në këtë gjendje kam vazhduar të ballafaqohem me ta edhe pse kam qenë i vetmi në mesin e tyre përderisa nuk kam mundur të qëndroj në këmbë, derisa unë isha i shtrirë në tokë afër meje ka qenë një mjet i metalët-shafciger me gjatësi 30-40 cm, të cilin mjet e ka pasur në dorë një person me maskë dhe ka tentuar me më goditur me të njëjtin mjet dhe unë me krejt fuqinë që kam pasur jam ngritur në këmbë dhe kam dëgjuar disa zëra duke thënë "hajde më shpejte se veç po shihet se na ka marrë vesh kush jemi", dhe nuk ju kam njohur zërin këtyre dhe personat e njëjtë janë larguar nga vendi i ngjarjes me një veturë kombi, ngjyre e bardhë, pa tabela, i cili kombi ka qenë i ndezur derisa është zhvilluar e tërë ngjarja në distancë mes 20 m në afërsi serës, unë kam mbetur në vendin e ngjarjes dhe jam ulur në tokë afër drunjtëve sepse u ndihesha shumë i lodhur prej goditjes që kam marrë dhe shumë i trullosur e kam ndezur një cigare dhe pas cigares aty më kishte pas marrë një lloj gjumi kur jam zgjuar dhe kam shkuar në shtëpi dhe i kam njoftuar babën, vëllezërit, mixhallarët për rastin që më ka ndodhur, babai im A. D., e ka njoftuar policin, në sera është vjedhur burmashina, brusalica, agregati e ka vlerën prej 1500 €, po ashtu më është vjedhur edhe kuleta ime me sasi të hollave në vlerë prej 70 €, të cilën kulet e kam gjetur pas disa dite në një distancë prej 150 m në largësi me seren, po ashtu shton se jam i dëmtuar dhe nuk paraqes kërkesë pasurore juridike veç dëshiroj që kjo çështje të kryhet sa më shpejtë.

I dëmtuari A. D., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në natën kritike pasi që ka ndodhe rasti në shtëpi ka ardhur djali ime L..., ka qenë në gjendje gati të alivanosur dhe i stresuar në maksimum, lëndime ka pas në vetull në anën e majtë, e kam marre e kam shti brenda djalin, e kam pyet gradualisht se çka ka ndodhë, me ka thanë se kah kam ardhur prej pune te sera ka ndodhe ky aksident, njerëz te pa njohur kanë tentuar me marrë diçka në objekt, e kanë sulmuar, ku të njëjtit e kanë vjedhur agregatin dhe disa sende tjetra, me pas kemi shkuar bashkërisht në vendin e ngjarjes e kam pare që sendet të cilat kanë qenë aty mungojnë dhe prej asaj dite unë nuk kam kurrfarë njohuri se qysh ka ndodhe ajo vjedhje, me pas stacioni policor në Vranjevc, të nesërmen më kanë thirre dhe më kanë thënë se e kemi gjet një agregat, është konstatuar se është agregati jon e kam marrë dhe e kam qu te shpija, po ashtu shton se e konsideroj veten si të dëmtuar dhe nuk paraqes kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Sh. I., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të akuzuari A..., e njoh nga fëmijëria, ndërsa të akuzuarit E..., dhe B..., i njoh për mes A..., këna nejt si shoqëri, ndërsa L. D., e njoh moti, me dt. 22.12.2017 unë me A... dhe vëllaun tim D..., kam qene ne kafe "K..." që gjendet në fshatin V..., Komuna e P..., ka pas muzikë, kemi qëndruar prej orës 23:30 deri në ora 01:00 pas mesnatës, pas 30 minutave në atë lokal na është bashkangjitur edhe L. D., dhe gjatë qëndrimit aty të gjithë kemi përdorë alkool, atë natë me sa më kujtohet ka pas ndërprerje të rrymës elektrike dhe pronari i lokalit ka thënë se kush ka agregat ta bien këtu në restaurant, L... e ka pru agregatin me veturën e A..., pronari

i lokalit na ka thënë se mbasi që erdh rryma menjëherë mos e hiqni agregatin prej veture , me pas çelësat e veturës ia ka mare E... dhe ka dalë nga lokali, e çka ka ndodhe mandej nuk e di, atë natë në muzikë ka qene edhe i akuzuari B. T., , po ashtu shton se me veturën e të akuzuarin A... e kemi dërguar L... në shtëpi.

Dëshmitari D. I., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e njoh te akuzuarin A..., e kam shok , ndërsa të akuzuarit E... dhe B... dhe të dëmtuarin L. D., i njoh shumë pak , me dt. 22.12.2017, kam qenë në kafenenë V..., ka pas muzikë, fillimisht jam kanë me A. L., , E. R., dhe B. T., kemi qenë me një tavolinë ulur të gjithë, pas gjysmë ore në tavolinë na u ka bashkëngjitur edhe i dëmtuari L. D., kemi pi edhe alkool , atë natë L... ka vallëzuar me këngëtaresh kohë pas kohe, me pas rryma është ndale pas gjysmë ore dhe shefi i lokalit të muzikës na ka pyetur se a ka dikush agregat, L... me veturën e A. L., ka shkuar e ka marrë agregatin te shpija e tij , në momentin kur ka mbërrir L... te lokali ka ardhë rryma , agregati është metë në veturë , më pas nga lokali ka dalë E. R., pas 20 minutave pas tij ka dalë edhe L. D., për veç këtyre dyve nuk ka dalë askush tjetër, kur u hy L... në lokal na ka njoftuar se agregati nuk është veturë, ka ora 01:00 dhe 02:00, e mesit të natës jemi qar nga lokali të gjithë se bashku, unë, A. L., dhe vëllau im Sh. I., e kemi dërguar L... deri te shpija e tij .

Dëshmitari N. Z., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me dt. 22.12.2017 , e kam pas lokalin tim “K...” që mbaj muzikë live , në fshatin V..., nuk i njoh L. D., A. L., dhe as E. R., por B. T., më kujtohet si figurë më përngjan si mysafir që ka qenë në lokal, ka ndodhe që gjatë kohës sa e kam pas lokalin në fshatin V... mu ndalë rryma, dhe prej kohës që unë e kam qelë lokalin e kam edhe agregatin, nuk ka ndodhe prej mysafirëve që unë me kërkuar agregat pasi që unë aty i kam 100 mysafir dhe te dal e të lypj agregat është e pa logjikshme dhe tërë kohën që e kam pas lokalin në fshatin V... nuk ka pas përleshje me persona të rinjë.

I pandehurit A. L., ne mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor deklaroi me dt. 22.12.2017 , kemi shkuar në muzikë në kafe në V..., jemi kanë shoqërisht në tavolinë, unë , Sh... dhe D. I., , B. T., E. R., brenda 20 minutave ka ardhë edhe L. D., është ulë me neve , pas 20 min u ndal rryma, pronari i muzikën na ka pyet kush ka agregat, L. D., dhe ka thënë se unë e kam agregat , L... mu ka drejtuar mua dhe më ka thënë a ma jep kerrin të shkoj te marrë agregatin, kur është kthyer L... në atë moment rryma ka ardh, L... e ka lënë agregatin në veturën time , me pas E... më ka thënë mi jep çelsat e kerrit se po dal pe kryej një nevojë, me pas E... është kthyer në tavolinë, mandej është dalë L. D., jashtë, kur është kthyer brenda në lokal ju ka drejtuar E... dhe i ka thënë eja jashtë , më pas 5 min , jemi dalë të gjithë jashtë dhe kemi pyetur se çka ka ndodhë, L... ka thënë se ma ka marrë dikush agregadin, ka më mbyt tashti babi, me pas e kam dërguar te shpija L..., unë u nala që ti qes kerrit naftë në “All Petroll”, në V..., B. T., dhe E. R., rastësisht i takova atu, hyra dhe e pina një kafe, E... më tha e kam ba një gabim të madhë, unë e kam marrë agregatin, unë i thashë më ke pre në besë e ke keqpërdorë kerrin tim dhe ktheja agregatin L..., E... e ka dërguar në shtëpinë e tij agregatin pasi që nuk ka pas veture me ja kthye L... agregatin.

I akuzuari E. R., në shqyrtimin gjyqësor e shfrytëzoi të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje.

I akuzuari B. T., në shqyrtimin gjyqësor e shfrytëzoi të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje.

-Lidhur me vërtetimin e gjendje faktike, gjykata vlerëson se,

Është kontestuese deklarata e të dëmtuarit L. D., pasi që deklarata e dhënë në shqyrtim gjyqësor me deklaratat e dhëna në fazat e më hershme janë kontradiktore rreth kohës së ndodhje së veprës penale, i dëmtuarin në deklaratën e dhënë pran stacionit policor me dt. 22.12.2017, ka deklaruar se unë pas goditjes nuk kam mundur më të qohem dhe kam parë tre persona dhe një kombi i modelit ... ngjyrë të bardhë, targa nuk kishte dhe me shpejtësi kanë vazhduar ( ikur), kurse unë kam mbetur i shkrirë në tokë pas 40 minuta jam zgjuar, ndërsa në deklaratën në prokurori me dt. 30.01.2018, ka deklaruar se pasi kanë ikur këta persona, unë në serë nuk di sa kam qëndruar sepse kam qenë i trullësuar nga goditjet që kam pasur në kokë veç kur jam ngritur në këmbë e kam pa orën 02:45 min pas mesnate, ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor përgjigjet se rasti ka ndodhë në ora 00:30 minuta për afërsisht, e tërë ngjarja është përfunduar deri në orën 02-45 min, kjo është ndryshim i madhë në kohë, po ashtu është kontestuese fakti se i dëmtuari L. D., pas punës ka ora 11:40, ka shkuar te sera sepse ka vërejtur një person të pa njohur me masë, pasi që këtë rrethana e sqarojë deklaruar e dëshmitarëve Sh. I., dhe D. I., se i dëmtuari L... afërsisht orës 00:00 deri pas mesnatë ka qenë në lokalin e muzikës bashkë me ta, andaj gjykata konstaton se kjo deklaratë ka qenë e formuluar nga ana e të njëjtit me arsyen që mot të ketë mosmarrëveshje me familjen e tij lidhur rreth vjedhjes së agregatit, andaj gjykata të njëjtat deklarata e ka vlerësuar si të pabazuar.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese dëshmia e të dëmtuarit A. D., pasi që i njëjti nuk ka pasur njohuri për ngjarjen, është bazuar vetëm në të dhëna e informuar nga i dëmtuari L... se si ka ndodhë rasti në fjalë, e njëjta deklarata nuk është relevante për këtë çështje penale.

Gjykata gjen dhe vlerësoi se dëshmitë e dëshmitarëve Sh. I., dhe D. I., konsideroj se në tersi është vërtetuar se te pandehurit pas marrëveshjes paraprake natën kritike, i pandehuri A... ia ofron çelësat e veturës tij të të pandehurit E..., ku i pandehuri E... shkon e veturë që gjendet në parkingun e lokalit të lartcekur dhe nga bagazhi e merr agregatin dhe e fsheh në vendin e caktuar, vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale nga dëshmia e të dëmtuarve-dëshmitarëve të lartcekur të cilët në mënyrë të ngjashme kanë përshkruar veprimet e të akuzuarve, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarëve të lartcekur vërtetohet se i dëmtuari L... afërsisht orës 00:00 deri pas mesnatë ka qenë në lokalin e muzikës bashkë me ta, dëshmit e të cilëve gjykata i ka vlerësuar si dëshmi të sigërta dhe objektive.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit N. Z., i cili e konsideron te pa mundur që ai ka kërkuar agregatin nga musafirët, nuk i njeh të akuzuarit dhe as të dëmtuarin, të njëjti i duket e pa nevojshme prezenca në gjykatë dhe nuk dinë asgjë për rastin në fjalë, andaj gjykata të njëjtat deklarata e ka vlerësuar si të pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar ekspertin mjeko- ligjore, të dt 12.01.2018, është konstatuar se i dëmtuari L. D., në natën kritike ka pësuar plagë shquese rreth syrit të majtë, lëndime këtë që janë shkaktuar si rezultate i veprimeve mekanik të mjetit të fortë mbresë ,

që kualifikohen lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, gjykata vlerësona qe në asnjë deklarata të dhënë nga dëshmitaret gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është



vërtetuar se i dëmtuari është përlësh me dikë apo kanë vërejtur së i dëmtuari ka qenë i lënduar, ndërsa i dëmtuar L... në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ka qenë i lënduar, po ashtu edhe babait të tij A... në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se i dëmtuari L... ka qenë i lënduar në natën kritike kur ka ardhur në shtëpi, ku gjykata ska mundë të vërtetoj se me të vërteti si ka ardhur deri te lëndim i të dëmtuari L..., ka qenë vetë i lënduar apo është lënduar nga ndonjë person tjetër.

Gjykata gjen dhe vlerësoi mbrojtjen e të pandehurit A. L., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, konsideroj se në tersi është vërtetuar se te pandehurit pas marrëveshjes paraprake natën kritike, i pandehuri A... ia ofron çelësat e veturës tij të të pandehurit E..., ku i pandehuri E... shkon e veturë që gjendet në parkingun e lokalit në fshatin V..., dhe nga bagazhi e merr agregatin dhe e fsheh në vendin e caktuar, vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale cili në mënyrë të ngjashme ka përshkruar veprimet e secilit të akuzuar veç e veç , dhe nga dëshmia e të njëjtit vërtetohet se i dëmtuari L... në natën kritike ka qëndruar bashkë me ta në kafe në fshatin V..., e cila deklaratë është identike me deklaratën e të pandehuri A... të dhënë në polici dhe në prokurori, të cilës deklaratë gjykata e ka vlerësuar si dëshmi të sigurtë dhe objektive.

Andaj Gjykata gjeti dhe bëri ricilsimin e veprës penale sepse në veprimi i të pandehurve A. L., E. R., dhe B. T., ekzistojnë të gjitha elementet se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par,1 lidhur me par 31 të KPRK-së, dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj asnjë rrethanë nuk u vërtetua se me veprime e të pandehurve të lartcekur janë përgjegjës për veprës penale Vjedhje grabitqare, nga neni 328 par,2 lidhur me par 1 të KPRK-së, siq pretendon prokuroria e shtetit.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese për të akuzuarin ka marrë gjendjen e tijë familjare, është mbajtës i vetëm të familjes, gjendjen e tijë ekonomike, faktin se ma parë nuk ka qenë të gjykuar, sjelljen e tij korrekte gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore, ndërsa që rrethana rënduese nuk ka gjetur, andaj, bazuar në këto rrethana gjykata i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimet e shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtit si dhe do të ndikojë në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPRK-së.

Palët e dëmtuara L... dhe A. D., nuk janë udhëzuar për kërkesë pasurore juridike pasi që në seancën e shqyrtimi gjyqësor te datës 13.03.2019, se cili veç e veç kanë deklaruar se nuk paraqes kërkesë pasurore juridike në këtë çështje penale.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.36/18, dt.20.05.2019**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
Shpresa Sahiti

**Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja**  
Violeta Namani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.